

***NANDO ELMO***

***Dhurata***  
***Vjershe***

*Gjufin çë me dhat' e vapkë*  
*Ju e prier e qosme*



*Stampato in proprio  
Rivarolo Canavese Maggio 2017*

*Copertina di Cesare Elmo*





## PARATHËN'JE

*Botonj - ng'e di pse, po, sigurisht, sa të mundinj me lehtësi pjakerinë, e më e më sa të pështonj ka humbja disa fjalë që sot të rinjët nëng përdorojin më - këto poezi që shkruajta më se tridhjetë vjet prap, kur fuqia shpirtërore ish akoma e tërë edhe e paprekur. Pra jarru moshë me dhuratat e saj të zeza: varesia, sidomos.*

*Qëftë i duruashëm ai i riu që do të përpykë këta shkrime, jam i bindur se s'shkruhet më kështu. Ndrishe thënë, poesia sot ka pak llokë te interes'i lezuesvet. E vet pjeq si u i venë akoma prapa vjershevet. Po u dua sot vet t'i bënj nderë atyrve që më lanë, si palë, e çmuar, këtë gjufë, ç'u di të varfër, po që më nget për mbrënda sesi ngë bën litishtja e cila më tringllisin ngamonë e huaj. Kapirinj se ket kjo e dyta u rrita intelektualisht, e se ndose kam të shkruanj shurbise t'urta gjufa ime arbëreshe gjymton fjalësh. Po te situata e tanishme kur dua të shprëhinj shurbiset më të thella të shpirtit, ato të parat që gjegja kur isha djalë e që më singuan për ngamonë, kam të prirrem ket thjeshtësia e arbërishtjes. Këto poezi do t'jenë një takim jo vet me të mbdhenjtë të mitë po edhe me shpirtin e llokut, me shpirtin e katundit ndë mes të cilit fati më shtu dyzet-e-tridhjetetë vjet prap. Një takim me fjalat me të cilat gjeta tash t'intepretuar botën te ku u rrita. Një takim me botën arbëreshe e cila, për sa mund*

*të bënj, ngë di akoma çë domethenie ka: një ëndërr i bën pikërisht me fjalë.*

*Këtu qetem e zënë fill e më burthofen gjithë ata çë shkuan mbatanë e çë lanë Firmozën vakand, pa thërritje djalësh, sidomos; pa një qen, pa një maçe, pa një gadhjur, pa një guxhurub vasilikou o me një garofolith të kuq ndër dritësoret, ka nani gjegjet vet vjersh'i lig i kukuvisë, çë bëri folenë ket dhómat e shkretura.*

*Qeva vjet Firmozë të sprasmin herë. Përshkova të tërë katundin. Të mbilltur pëllaset e Frashinravet, të Kaparellravet, të Rusanravet, të Buonravet. E mbullitur shpia ime. E mbllitur kanonk'e zotit Viçenz Matrangolo çë do të kish t'ish thavmasj'e katundit. Mosnjeri ndër udhët. Vakand gjitonitë. Mosnjë çë prëfej ket skallunet përpara derës ture marr frymë ka zdripj'e malit, ose ka hipja e farnitavet. Po ish vakand edhe qielli. Pa dallandishe pse më katund ngë janë më kafsha; jo dhenë, jo qe, jo gadhjurë, jo pula, jo gjele ç'i bëjin hare të haraksurit me këndimin e tyre. Kisha vet më zëmër këto fjale çë m'u duktin të kota, pse ngë kisha me kë t'i shkëmbenja e veja i shkretë ka rrahj'i Farnitës ture kërkuar ajret çë hipen ka dy dete sa t'i shprishnja si kamnua çë spavet ket era. I qelnja këto fjalë të kota si një shëmrall, një kunet, një nuskë apotropaike, kundër një të marrë sysh të historisë, ç'është e na humbin. Pse fjalët janë shpia te ku u rritëtim: Fjala na bën njeri. Te fjala krijomi botëncë pra banomi. Te fjala përpjekmi të tjerët. Te fjala njoh gjitoninë – sot fjalës sime arbëreshe i përgjegjet e huaj vet litishja. Te fjala njoh gjiriun. Po te*

*fjala e dhënë e e marrë lefet jo vet dashuria po edhe zilia, edhe kundrastimi. Kem' t'i kemi kujdhes fjalëvet. Si thoj Gorgjas-i: λόγος μέγας δυνάστης ἔστιν, ὅς σμικροτάτω σώματι καὶ ἀφανεστάτω θειότατα ἔργα ἀποτελεῖ / fjala ka zoteri (qeverri) të madhe, me një kurm shumë të vogël edhe të padukur piksin shërbise hyjnore. (“Hyjnor” ketu vjen me thën: “çë piksin jetë / me fjalë diktatoret, çë do llojeje, na bëjin të bindur të jetjesh çë ekzistojin vet ket trutë e tyrve). Këtu hapen aporitë e vështira. Edhe pse Gorgja, ngamonë ai, thot: οὐκ ἄρα τὰ ὄντα μὴνύομεν τοῖς πέλας ἀλλὰ λόγον ὅς ἑτερός ἐστὶ τῶν ὑποκειμένων / atyrve çë na rrinë prëzë ng'i ofromi shurbise po fjalë, e një është shurbesi, njetër fjala. Po kem'të thomi, përsëdrekti, se vet me fjalët na mund të ofromi njersinë tonë. Detyri i shkrintarit, sot si sot (i së sotmjes postmodherne - postmodhernia e postmodhernies), është vet të burthonj dobinë, dështimin, gabimin e tij. Mbaroj mot'i sigurimevet, i së “virtetës”. E vërtetja, për shembull, bëri shumë dëme. E u, më këtë të “vërtetje”, benj më mirë ndose kputinj këtu diskursin - e qetem.*

*Po këto timet janë fjalë të shkreta si e shkretë është shpia ime Firmozë. E shpresonj se do të duken të buta si muzika e butë e njëj pitiqe të pisëruar çë natin më gushullonej ka gjithë dështimet timët. Ringjalljin, paraqitjin vet fantasme. Kujit i përkasjin sot këto fjalë? Nani ju i ofronj. Ndose ë pak për ju, katër pesë çë më djavasni, më pafshit lipisi*





*Kushtim*

*Në kujtimin e prindëvet e mi që më lindëtin arbëresh  
Nikollës e Zonjës Mari' e DeMarkut*

*Ashtu mendja m'u hapët  
si herë e herë hapet*

*Firmozë*

*Ndë mest re të rënda shiu  
nj'e shkëlqier thelë qielli  
ket ty mund të zografsish  
lavdinë e Perëndisë  
e të ndrishe ëndresh  
m'u fanarostë hare*

# 1

Ju lutem

një kurorë gruri  
me fjamurin e lulëkuqit

më zëmër t'ultën ver'e gjitonivet,  
e e dashurisë,  
të së cilës do,  
më tru hardhëlin

do të priremi në Thermopil

na pret njëqindkrerori  
Angëth i Perëndimit  
Enthusjasm'i litirvet  
çë do të sdorrokopsinj  
butësirat tona

e “Sonde do t’jemi pa të ftuar  
ket dark’e të vdekurvet”

2

Ngë kam më të fjas  
në gjufin arbëreshe

më ndan një hon  
ka të tjetër veshë

i ngau litirja  
me domethënëje të huaj

hapën hone  
midhis të thënit e se sa ndiemi

ngë kemi hapë  
për honet e domethënëjes  
ndiemi vet ehoat  
çë na troqisëjin trutë  
e na qellëjin të babartur

ndë mes të gurve të gjitonivet  
fratumala fjalësh

çë një herë qellëjim  
më zëmër  
të humbur si farë

per të cilin na fjit ngagjë

nani rrimi të hapët si shega  
çë na fton  
me njëqindët sytë e saj të kuq

e na shkundin  
nj'erë e ftoftë  
çë frin ka gjithë këndet e jetës  
e s'kemi ku rrëçetë

### 3

Ti çë ke ëmër Ëngjëli  
sillim lajm' e paraqitjes sime

trokollisinj ka dera jote  
e pres përgjegjen tënde

mund t' jet se ndër sytë e tua  
u ka pindaksur një sionë  
ç'u buar ndër rugat e jetës

shif ndose qindron  
ndonjë shenjë  
të fandasivet  
çë banojin  
kujtimet e mia

ndose ke akoma ket buza  
e shtipur lënësinë  
ket gjiri lëshimin  
ndër shalet humbjen e lezë

përgjegjëmu me ehoa

çë s'duan të më taksjin  
paraqitjen e vërtetë

4

Istori Istori  
pa gjitoni na lè  
pa kurm pa shpirt

një guli  
anamesa dhëmbët e tua  
të kalbët  
llargu na pushtite

5

S' dua të të pres  
të të përpjek  
ndër lloket  
e shkretërisë sime

lëmet që s'banon më xhapia  
vreshtat ket ngë lefin më  
dhelpra

malet ka ku shkapëtoj  
ulku  
e vete e sëmur kacamitja

s' dua më të të pres  
ndër rugat  
ka ngë shkon më vallja e dejme



ku harrojim gjithë angëthet  
e vetmisë sonë

eamë ndër ëndret  
ku duket se e vërtetë  
ka jeta një domethënëje

6

Jan e ju siellëjin të mirat  
ka gjithë këndet e jetës

e dhëmbësia do t'ju bëfjet  
më e zezë

do të hini me kokakolin  
ket errësia e Perëndimit  
çë veshin stoli  
të farmakosura  
se si këmish'e Nesit

llargu llargu  
ka dhurtilat  
ç'ju premëtojin  
shpëtimin ka dhëmbja rrënjësore e jetës

7

Ndë mest krafët e tua  
barr' i gjellës sime  
m'u duk më i lezë

mund t'jet se do të kisha luajtur  
per gjithmonë  
një valle e dejme

e së cilës  
fati më dha të ngjepsënja  
vet një pemiparë

një dorë perëndije  
më llargoj ka ti

moti do të kish  
shkatarruar më varesinë  
verin tonë  
e rë

më le kujtimin  
çë nëng më ngushllon

8

Pat' të llargofsha ka ti  
për të të dinja angëth i math

për të të dinja gjimësa e shpirtit tim  
çë dhëmbësisht më gjimëton

u bëre nani shurbes i nevrosisë sime

pse jam i vapëk i vapëk  
s'e di se pse

po s'ishe bëgatëri  
s'ishe ngushulim  
kur prënja kryet  
ket gjiri yt  
e gjishtët e tua  
krefëjin rushkulin lesh tim pjot erë

9

Isha i tërë vet ket ajo mortje e vogël  
ket më ftonje me mishët tënd

ket ajo humbje  
ket birsha i tërë

ture hitur ket të fshefurat e tua  
ture gjetur vendin e mosqënëjes

isha i tërë ket përroje e syvet të tu  
pa fund  
te ku më thërrit  
ehoa  
e së parës qetësi

## 10

Sytë e dialoshravet  
e kopilavet  
gërshërtë e gërthlavet

ulurim'i ulqëvet ndër brinjat  
e kurmi yt  
e turpi  
gjaku

thirrmat e shtjerravet ndër shpellat

ngresj'e erës zanëhyinore  
mbi pasiqirin e ujravet

vorë  
e trëmbja e rahallit tënd të math ndër honet

falenderim'i ullinjëvet  
i orazvet e kronjëvet

poshta ndër vreshtat  
qetet arëza

shtërpon qeshja e natës  
me lodhësinë e kodhravet

Gjë shkoj  
ndër qikët e ditës  
frimëmadhe  
e na la si shpia e pabanuar  
pa gazet e lënësitë e trimavet  
e malinkonivet të gjithë stinavet të hapta

mora vesh  
ng'ishin shkele Hyinish  
cë bashkojin  
qetësinë e drizavet ndër llakat



11

Të lumtat gjitoni të mendjes  
gurë bregu  
vidhe shkëmbe

pëllumba kullumbrari  
ket një raganielë një grusht kaltrije  
ndëndnej gojin grifçavet gargullaqe

bënej suvala era ndër dhomatët  
thekrat visitonej fjeturim'i qiftit  
farnita e të korrave  
kish ndër sporet lulëkuqi  
shoqërinë e hardhlavet

ktu piksej  
lodhesia e ditavet

hapa profitave  
kallamet e dhespërit

buzë pa të rreme  
përhapa e vreshtës

mbatanë na  
na thërret qetsia  
prëfemi  
thamë shumë  
prëfemi  
thamë keq

12

Shpitë e qiellit  
ylëzit e pramendës

loset kufia  
e syvet të tu  
si marr rrugat e mosqënës

frimëmadhe  
u zdripte si u ngre vorea e natës

past gjufa jote ujëra të t'ëmbël  
taraksje kurmi

si shpjekse hjetat  
suval'e paraverës  
hiri ndër manushaqet e tua  
pa mejtime  
pa fjalë  
pa shprehje

mos na marrët sysh  
perëndeshë

varresi' e ditavet

na lëft natin pa merë  
hifit dhelpira ndër vreshtat  
pa lefmin e qenëvet  
e qeshët se sa më mundët  
me gazet e tu  
yll'i dragules

13

Dimri

ehoa vjershesh  
tringëllimesh uji

na zë nata  
dëbim malsorve  
rrëkime degash

halkomat tiravolet  
fiselet  
rugënjat e ditës

upritë  
la me draprin lehmin e qenëvet

vesë fjalesh e kujtimesh  
le shenje mbi borës

e ty qëllone  
ture pritur njetër paraverë

**14**

Haraksin  
dita priret me rrethin e njëjt

ng'jan tuat ditat e tua  
pse do t'jesh i ditavet?

masin hapet mbi likurës  
ora  
më e liga do t'jetë më e mira

mur i ngarkalesur  
i kanoset mullënjavet  
mor'e maçavet

e ty djalë çë do të kish' t'ishnje diellor?

të shufet qeshja  
midhis lozjet e mbrëmjes



15

Duar  
gjisht  
vëllimi im  
vë pendat e deshirit

më fjasjin ket i theksuri syu yt?  
qifti  
xhapia miza  
fjetat e lisit  
barërat e buzës së lumit  
pasiqiret e fixhës sime

ushqim ushqimi  
s'prëfem ket i dreqti rrethë i qënës

urtësi e pagjegjur:  
“e ket vëllim’i saj është paqja jonë”

16

Qindriu i fatit  
kam gjith lakosat  
lavditë e gjellës

gjegja  
më fjashtasin  
gjelin

per cilët tradhtime?

hapin mjergullat e haraksit e burthofet dielli

biret kendim'i gjelit me ehoat e honevet

17

Burthom ku vete udha  
ka rrugulliset shkëmbi  
e hipet drom'i malit

kush ata çë ven  
ata çë vijin

lanë shenje kafshat  
lanë lesh ndër ferrat dhentë

shpirtrat e të vdekurvet tanë

pas tij më thërrert një fatë  
e hinj anamesa mjergullavet e majit  
teku bier një shtog majapkat e tija

**18**

Me erë me duke verje  
ngjepsa fandasi

arrat ullinjët  
hjetat minutilësh  
thelsitë e gjellës  
kanolët ket triesa jote  
më siell më urtësi barku se mendja

e tundet e luan lozjen e saj  
murtila  
si rritet deti e zbardet  
me anagasi të e shkumavet

spëlithi thërret skupullin e furrevet  
e masna qelqin ty

sydëlir kopil

ngushulon triesa dëbimet  
më se një shpresë parrajsi

19

S'njof më fixhin time  
u buar për udhët e jetës

t'jap kët lozje fjalësh  
koqez për një ciez e bierr  
anamesa qatrit e dimërit

kur do t'i djovasësh  
nj'erë  
një dukë  
një ngjirë  
do të të bëjin  
atë cë s'guzonj u nani

pindakëshin për tijë oj çë llargu banon  
e të qellëshin dhunë  
nj'udhë mali  
një mallkim ndër vreshtat  
një diersë ndër të korrat  
livandat çë kamnisjin syun  
Asaj çë tharteson buzqeshjen tremballaqe  
e ëmbra Zonjushe Odhigjitrje

e sa na ngushullon thartësitë e ditavet  
vera e përpjekavet  
vilakosit e natavet  
vetmia e hënës që zbardhënej gjitonit

e të parin dhunë  
shpinë tonë arbreshe  
çë qella shëmëral  
talisman për të huajat magari

më pashe benë  
ty që sonde më ngatarren me tokun e ëndravet  
trandafilet e tua e manushaqet  
njota më shprishjin tashi m'odë erën e tire

20

Mote kurpëri e manushaqesh  
e ki ujë javëmadje

hapin mund t'jetë  
ka mesimvria

e ty Zonjë  
zdripe Mari për këtë e Shtunë e Shënjëte

të qellin dhunë  
një ngjir kardhakaqesh  
nj' erë dhafnëje  
të njomët grurët  
çë gjelbëron  
helmin e sumbullkevet

mund t'jetë se gjë do të ngjallet  
mund t'jetë se gjë do të priret  
mund t'jetë se gjë

një fixhë biri



do të burthofet ket mjergull'e vetmisë

do të kesh, mëmë, një parkalesje  
një shpresë së ardhmje

e kujt?

mos ng'ish për atë buzqeshje  
do të të mundenej thartësia

cili fat  
për të cilin e perëndivet  
llargu na magjepsi?

21

Muzika jonë  
çë s'ka të rrufier

lotët  
thlipset  
tarakset e natës

një vrundull erje  
ë e na qellin dhunë  
me fjetat e vjeshtes  
ndër prahet e këtire gjitoni të huaja

na merr me të lebixhi  
çë fshin gurët e udhëvet e Xhenova-s

42

e qetin zemërin  
thamasja e suvalavet  
çë lodhen pa kufi mbi shkëmbet e detit

Me t'e ndrishme vorë  
na sill gëzime mali

22

Urtësitë  
fjalët e të mbdhenjëvet tanë

jo më e ligë farë  
për sporetë e mendjes

jo më e rreme perëndi

jo më pak e dejme se tonat

e shkretet qetesi' e ullinjëvet  
qetet ket prahu diellor  
urtësia e syvet të maçes  
ç'i ultësufet e paqme gjumit

çafet rreth'i e vërtetës  
ket goj' e kacamitës  
ç'i jipet e butë  
urit t'ulqvet

44

23

Flakat e zjarrit  
zierja e mushtes  
qeshja jote që spavet  
si të pikset ndë fixhët  
ai angëst që të njof

re erë  
shkumë suvalje e palodhme  
dridhëm momenti  
lozje qesharaqe  
një të shkuar anangast dialoshrash mb'udhë

njota qifti  
së kodravet nani që spavet mbatanë kufisë  
janë se sa do metaforat e qënës sonë e dhëmbët  
të ngatarrier me shkoka fjalësh

t'i siell me poni  
durtile vjeshtje  
te ku ti gjëfshe atë që dafshe

sivonë ime çë të mashtron  
pindaksin më ngjira të ndrishme  
fikapalleti një llakë

e shita vreshtin  
s'kam më për tij  
një panare fiqë

24

Se si do mos të dhëmbem

tha : vre qiellin  
kaltritë e mia  
arët e dhomatavet të pjekura  
përposh diellit të mesimvrisë

i ëmbli mik  
kujtonj të xheshurat e tua  
vapkësitë  
erin e diellin  
shirat ç'na lagëjin  
ndë mest shifnat pjot rrush  
vjershin e mullënjavet ndër Masavetrat

kjo dobësi e shemëtuame

kush do të na mbanj dorën  
ka degat  
ka gurët  
ka muzkat  
ka barërat

kush do të shtronj një pulluin  
me ponitë e moçme ti thua

e më lemë bredh një shpirtefillet  
ture na qellur dhunë



25

Gjëmimi  
e vet drit'e shkeptimit

e e zezë Mulla  
sa i zezë është nj'angth

e shiu

e pra ndodhja  
e pandodhja jote

çudia njëj fjalëje  
çë më bënej tij i huaj

bën kështu mjergulla

e hapin një shperiz dielli  
qeshjen e voësës  
çë qindisin qesharaqe  
harakset e dimërit

26

Qeve shi sheshë  
vorë çë zdropet dal' e dalë  
ka malet  
likur  
buzqeshje vreshtash  
sy zeks  
dallandishe bishtkriqë  
krah spilith  
rrugullimë pa fund  
hundë  
qeshje  
hapesi shpi e gjitoni  
ikje  
lipisi pa ngushullim  
errësi

tore toqe  
nëngje trikuzje  
ndër sporet e ditës  
te ku nata mbiell  
angthet  
me dritin e urtësisë

honë shpellë  
bishtë kreshmeshi  
ujë llavinëje  
murgë trapiti  
ngryq e shryq  
ngres ngridhje  
ngridje  
ultësi lahoni  
errësije

shkon e vete  
ujë lumi  
të rrekshtin qerojë  
me rrethin e stinavet  
e mjergullon kallëndrat  
çë humben ndër kuvelet  
e ditës  
kalthërit  
e syut tënd çë llargu vë rë  
e pret qetësitë pa kufi

oj e delira ket kujtimi im  
një falënderimë për gjithmonë

për gjithmonë

27

Javëmadhe e verdhë mimozash  
e kjo paraverë stake  
çë shtie se sa më mundin bar

e u?

ket ngresj'e erës  
së njetër moti  
me kurmin e Krishtit  
i gozhdjasur më kriqe  
krimb midis gjelbërit të njomët të sumbulkravet

oj, i njomethi kurm'i gozhdjasur  
za popo ty, një manushaqe  
një shkok dhafnëje

53

dy koqe livandi

za një dhelkë  
për mortjen time  
kur do t'jem i vetmë  
pa uthulin çë të siell  
një ngushullim falënderimi

**28**

Ujët e rraganëjelit  
qellin me të  
bëgaterinë e qelbur  
e progresit tonë

ujërat e gjelles

pandef ty një Shën Jan  
që të laft mëkatet

mejto, ndë mundëshe,  
ty këta gathe  
pa një gadhjur  
çë kullotin midis barit të ri

Ja thomi ka na Qiparris  
kët çë ty e quan “arvur”i të vdekurvet”

e po e shikonj ka anat e mia  
me djaloshrat e cingarvet  
(është po të tringellisinj dhesperi  
çë na fton të parkalesmi për anghet e natës)  
çë ven midis detit kundër diellit çë perëndon  
e spaven mbrënda çudisë së suvalës  
çë mbrënda gjirit të saj i mbullukon

nj’ënder çë thartson  
thirrma e gjatë e sirenavet  
çë llargu anangasen ndër spitelët



**30**

U ngrë i leze ka guret e lumit  
pásari i lënë

u ngrë e lënë ka udhët e botës  
zëmëra e leza jonë  
e pat këndimet e saj  
piruka e gjellës sonë

u spave e magjepsur  
gjella jone e lënë  
si muzika e totarit më lëmë

e qeshin hëna e pjotë e theristiut

**31**

Mot që lumi grisin gurët  
e prëfet ndër pusët  
të hinjët i meringuar

mitë e qelbësia e dhropëkës

vëfem mënjane

oj mot'i Bukurisë  
e ëndrur e pandëfur e dashur

jes, tradhëtim'i gjellës

Zani këtë helm të math  
 ju gra nani ç'ju shof pa stoli  
 pa të kuqin panë  
 fjamur'i zjarrmi ynë  
 gra pa hiresi  
 mbani kët helm të math  
 nani çë nëngë bireni më  
 ndër dhomatët  
 ju gra pa donatì

zani kët helm të math  
 ju gra çë s'bireni më ndër vreshtat  
 e shterpuat muzkat e hajdhisë  
 ju gra pa hjè

ju gra bukë  
 ju gra grurë  
 ju gra vere

ju gra merë  
gra dejtja  
e djalerisë sonë

ju gra sy të oksidartur  
ka varesi'e ditavet tona të shitura

Ndreqinj e prirem e ndreqinj  
këto fjalë gurë  
gërmadha që priren e gramisen  
trashgim i grisur të mbëdhenjëvet tanë

ndreqinj e prirem e ndreqinj  
fjalë kamnua  
që spavin  
një vrundul erje  
që ngamot ndëndin urin e dimrit

nj' erë ç'i hipin diellore  
ka fushat e Sybarit Firmozës  
ngjire e merë deti

e kodrat e saj të shqepura  
(teku banon xhapia  
tash ket syu i qiftit)

djepson me këndime falendërimi

ndreqinj e prirem e ndreqinj  
fjalë kanak  
çë të skroqollisin  
ka xerku qeroj yt  
pa durim

34

Gjegj këta piptime

jipi vesh piptonës së gjatë  
çë nata shprishin ndër rugat e saj  
me pitiqe e pisëruar

na therret na therret  
e na fton ket darsmja e saj e qetme  
humbja

gjegj këta piptime  
çë pipin  
pitiqja e piseruar e natës

63

35

Me zane të lashtë gjithmonë hijnore  
mikëj'e Saba-s dhì  
e dashura fixhe judiu  
me sy ujëdeti më vren

e çifut i dhembët më këndon

matajotes matajoteton  
gjithësej  
është matull kamnoi përposh diellit  
një shortë e njëjtë do të ketë  
matajotes matajoteton

i lashtë këndim  
i djalerisë sime



kur xathur vejim per hnersat e Firmozës  
e xëjim lozjen e hollë  
e revet që lëjin përposhë  
gjithë barrin e suvalvet  
e spavëshin ket kaltheri' e Marsit

lebixhi na ternej  
gjithë djersët e ballëvet

Me ngjiret  
e pendavet të gjelit  
gjumi më mbëllinej sytë  
e më djepësojin fjalë ëndresh

“Zo s’past  
pula pjast  
gjeli rroft  
e na këndoft”

e ngjire të ndrishme  
brez-i-pjakavet  
bisht’i gjelit  
kish zo nder harakset e Ungris  
ndër lloket e saj djellorë  
Shesh’i Sistit  
Bregu  
Burgu  
Kastjeli  
Kopsht’i Suvojt

Pëllas'i Bonxhokut  
Kandin'e Çesarinit  
Qenga

e tlooxhi<sup>1</sup> i qishës së madhe

për netët pagjumësore  
sytë tanë të magjepsur  
më parë se vdeqja e dishme  
t'atit e të mikut  
të na vizitonej e pa ftuar  
për të na sosnej lozjet

atë këndime donja per tij  
nani çë pjakeria  
të bëri  
njetër herë e vogël  
e do djepësuar  
për gjumin (t'ardhët i leze  
sa i lez ishë vjershi yt)  
çë do të të shtronj Perëndia  
për gjithmonë

---

<sup>1</sup> Fjalë ungërnjote për “oroloxhjë”, si thomi Firmozë

Ngë di ndose ndonjëherë  
ju the t'e vërtetjen

për sa shkarrarta udhët e botës  
ngë pe ndrishe zogj  
ndër dushqet

jo ndrishe shure ndër buzat e detit  
jo ndrishe shtogje  
nder kufinjet e kopshtavet

s'kishin të ndrishme sy  
ato që të magjepsjin  
më se tonat

s'di ndose ju the të vërtetjen  
di se më babaret gjufa ndë mes të dhëmbëvet  
e më venë fjalët të ngatarriera  
të lëna e pa domethënë

38

Dhurata juaj një kujtim falenderimi  
Falenderon kujtimin  
Fjalë çë na vë te llargësia  
Ka e cila vremi e judhikomi

Fjalë errësi  
Teku duket se marrjin dritë shurbiset

Një gjellë kujtimesh një gjellë gjikimesh  
Këtu do të gjëndemi  
Me njerëzin tonë  
qetësi tekua na e arrëjin zëret e jashtëm  
Ture ndërruar nganjë mendim çë na përshkon

*Ματαιότης*

Thoj plaku pa të na bën' të bindur  
Sa të xëmi pa mendje fare  
vallen e lezë e e dejme e gjellës

**39**

E këtu e këtëje qëndron e shtruar bora  
Dora e ngroftë e paraverës s'e ngau

Sdripet ka Alpet qetësia  
Më e thellë sa më e masin  
Llargu  
Tringëllim' i kumborës së Pasqëvet

E u i lumët si shëjt i Tao-it përmier

40

*Ka koprea trandafiles i vjen hjea  
(Thënie e urt e nanës sime)*

Kisha vën përpara derës së shpirtit tim  
Një petikua  
Sa të më shpëtovej ka thundrat e djallit

Veset tënd si të tillët i ndienja

Kocëngurtë ngucarnje  
Ngrënje vuxhin frymëmadhe  
Ligjin e donje nga herë pa kundrastim  
Vënje vërtetat e tu  
Si mur i ngardhamostë  
Kundër fjalët e mi  
Sa më ato të buta bëfshin

E më mirr djalli

Më çelshin trutë  
Sa të çelshin sytë e tu

Sa të të dhezëshin  
Kokazit e faqes  
Te ku hjea jote bënej folen  
E i bjerrur birsha  
Te honi yt pa fund



41

Sa vdiqe  
Fotografi te mërmur' i varrit  
U spav edhe gjella jonë e tërë  
çë rron vet ket syu  
E ket mejtim' i tjetrit

Sikur se ju bë një piçivërë roggjes së gjelles  
Ka nduki humbja gjithë verën e të miravet tona

U zhduktin lëmet e të korravet  
Vreshtat e të vjelavet  
Lis' i math përposh të cilit  
Harepshin grat e burrat  
Pra të fshirjes

U zhduktin buka e vera e haresë

Ehoa e kumborës së madhe  
Hapin hone humbje  
Harroj tash qielli fixhin tënde pjetë gazë  
Ecjen tënde për botë

Fjalët e tu të trushme  
Ç' e pindaksjin  
oj i dashuri mik botën tonë arbëreshe

Nani vemi të huaj te syu i të huajit  
Te veshi  
Te ku jemi të pasiqyrtur  
si fandazme

Kush do të më thërres më për ëmër  
Për të cilin, i bën i bindur, eksistonj?

Më pëlqen  
Ato mbrëma verje  
Pas gjithë ditën oftin e groftë e diellit  
Ajo merë ujërash  
Çë kanë potisur kopshtira  
Ka ngrëfen natën aromet e barëravet të njomë

U të prita këtu ket shkojin akuaret  
Ka Llumun'jelthi  
O si deshe ti ka Arrangunga

E fryn ajri i hollë çë zdropet ka Pallaci  
Hin ka dritsorja ture lëmuar vapat e natës  
E më puthin ballët

U kumbistin yllet  
Edhe hëna  
E u  
U qëllova i vetëm

## VALLËZORVET KA FIRMOZA

Kirkon e babartur fjala ime  
të thotë, lule,  
lehtësinë tuaj nani

Zogj e paraverës së Firmozës  
çë luani  
hjenë e shqitezis hijnore  
çë duron ket buz'e liqenit të gjellës

Hapat tuaj venë  
Si firfillimet e fjturis çë ngrëfet  
Si fjet' e këputur ka vore'e vjeshtës  
Ndir vreshtat e farnitavet

Ket nat'e nij gusht'i thavmasur  
Na dhezin drita mbrënda jashtzakonshme  
hiri'e Pjeres  
buzëqeshj'e Milljes

hollësi'e Marinës  
Annës bukuri'e shkëlqier

Vë re mbi lulet që rriten  
ket shkretëri'e gurve të bekuar  
ka ngjiret e aromat e detit Jon  
Bruna

Mbjedh e kënaqur mjalet e tire  
ket hapësira që na shtron e lumët muzika  
e ja dhuron ashpirsisë tënë tabane

I pirgjegjet lehtësi'e Viçenxit

E di Thuri që na rri pirpara hjimaz  
ket drit'e Sibarit  
vallen e Orfeut  
e po si kafsha t'egra na butëson

T'e mbajim një shtitje hirije  
e gazin e saj

Po shkojin e venë  
këndim'i cillezis anamesa borsë së Marsit

shpirtetilleti që hjed' më lëmë  
juskin e grurit

Vete vrundull'i erës  
që lehtëson afshin e llakavet

Drit'e illit shkon  
që na ngrën më sjetë sprënxa të rreme  
ket nat'e Firmozës e madhe  
që ngamot t'helmuar pishkomi edhe të huaj

Ju haristis juve lule mali  
pir këndimin që bët' e m'u le më zëmir  
si re e lezë që bired pa kujtim e hidhur

Qëftë pir ju jeta e lezë si vallja juaj  
me dridhëmat e shqitezis që njëf  
të rrjedhurat e ujit  
q' i delirë pasqiron kaltrit' e qiellit

**Nando ELMO** (arbërisht: Nandin'i Helmëravet) u le Firmozë (Acquaformosa, CS, Italy) ket e treta ditë e Shinmirtirit 1938.. Ësht skrimëtar, poet, eseist litisht e arbrisht dhe piktor i njohur. Bëri studimet te Universiteti “La Sapienza” Romë edhe Palerm tek u diplomar në literasi moderne. Te Univesitet’i Torino u ekspertizua në “Gjuhësi e përgjithëshme e Semjologjië”. Gjellon e vepron në Rivarolo Canavese te krahina e Torino. Ësht i cituar si i rëndësishëm intelektual arbëresh te libr’i Demetrio-t Emmanuele “Arberia”.

